



INTITUCIONET E PËRKOZHMEVETËQEVERISËSE TË KOSOVËS



Qeveria e Kosovës
Ministria e Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Raport sektorial

Raporti i zhvillimit hapësinor për sektorin e

TRANSPORTIT

Prishtinë, shtator 2004



Draft / dokument pune
Raport i sektorial i zhvillimit hapësinor për sektorin transportit dhe infrastrukturës

Transporti dhe infrastrukturura

Hartues të draftit / dokumentit punues

Ismet Hoxha, MTPT - Departamenti i infrastrukturës rrugore
Kamer Shabanaj, MTPT Departamenti i shërbimeve të transportit rrugor
Nexhat Bala - MTPT - Departamenti i transportit të aviacionit civil, hekurudhor dhe detar
Bajram Xhemajli - MTPT - Departamenti i transportit të aviacionit civil, hekurudhor dhe detar
Mehdi Berisha - MTPT - Departamenti i transportit të aviacionit civil, hekurudhor dhe detar
Qamil Feka - MTPT - Departamenti i shërbimeve të transportit rrugor
Arbën Rrecaj - MMPH - Instituti i Planifikimit Hapësinor

Prishtinë, shtator 2004



HYRJE

Në nenin 11.3 pika c) të ligjit për planifikim hapësinor 2003/14, rreg. UNMIK 2003/30 thuhet se plani hapësinor i Kosovës është plan strategjik multisektorial i cili bazohet në raportet e sektorëve të rëndësishëm të përgatitur nga ministrinë kompetente të Qeverisë së Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë, kurse në pikën e) të të njëjtit nen thuhet se ky plan merr parasysh strategjitë zhvillimore për sektorë të ndryshëm, përfshirë financat, arsimin e lartë dhe studimet, telekomunikacionin, transportet, minierat, prodhimin e energjisë, burimet natyrore, tokën më cilësore, sportin dhe rekreacionin.

Për këtë arsye këto raporte janë të nevojshëm në fazën e hartimit të dokumentit të VIZIONIT që është pjesë e planit hapësinor të Kosovës, sepse siq u tha më lartë plani hapësinor i Kosovës bazohet në raportet sektorale.

PROFILI SEKTORIAL, ÇËSHTJET, SFIDAT

Rrugët

Në Kosovë rrugët janë të ranguara në rrugët magjistrale, rrugët rajonale dhe rrugët lokale. Pra rrugët magjistrale janë rrugët e rangut më të lartë. Aktualisht (viti 2004) gjatësia e tyre është 647 km ku rreth 97% janë të asfaltuara. Pas tyre vijnë rrugët rajonale me një gjatësi prej 1278 km (viti 2004) ku rreth 76% janë të asfaltuara. Rrugët magjistrale dhe rajonale janë në kompetencë të Ministrisë së Transportit dhe Postë - Telekomunikacionit. Rrugët lokale që janë të rangut më të ultë kanë një gjatësi prej rreth 6000 km dhe janë në kompetencë të qeverive lokale.

Rrugët magjistrale më të ngarkuara sipas matjeve të vitit 2002 janë M2 - Hani i Elezit - Prishtinë me 16490 automjete në qarkullim ditor, pastaj M2 - Prishtinë - Mitrovicë me 11765 automjete dhe M9 - Prishtinë - Pejë me 10573.

Pas luftës në Kosovë janë kryer shumë ndërtime dhe kyçje ilegale përgjatë brezit rrugor të rrugëve magjistrale. Ky fenomen vazhdon edhe sot dhe paraqet një problem serioz. Kështu po rrezikohen korridoret për zgjerimin e këtyre rrugëve në të ardhmen, në masë të madhe është ulur niveli i sigurisë dhe shpejtësia e lëvizjes në këto magjistrale e po ashtu kjo ka degraduar edhe kategorinë e këtyre rrugëve. Rruga që më parë është kaluar për një orë (Prishtinë - Pejë), sot kalohet për 1 orë e 25 minuta. Në mungesë të transportit përmes hekurudhës, sidomos të mallrave me tonazhe të lartë, rrugët automobilistike ngarkohen së tepërmi dhe kështu vie deri te dëmtimi i tyre.

Hekurudhat

Niveli i zhvillimit të hekurudhave në Kosovë është mjaft i ultë. Vet fakti se që nga viti 1963 nuk është ndërtuar asnjë vijë e re hekurudhore flet mjaft për këtë. Vijat hekurudhore, me përjashtim të atyre që gjenden në disa stacione hekurudhore, janë vija njëfishe.

Këto vija hekurudhore ekzistojnë sot (viti 2004) në Kosovë:

- 1) Hani i Elezit - Mitrovicë - hekurudhë e ndërtuar në vitin 1874
- 2) Mitrovicë - Leshak - hekurudhë e ndërtuar në vitin 1931. Gjatësia e hekurudhës Hani i Elezit - Leshak është 174.747 km pa e llogaritur gjatësinë në stacion që është 66.294 km.
- 3) Fushë Kosovë - Prishtinë - Besianë e ndërtuar në vitin 1934 me gjatësi 45.198 km, kurse gjatësia në stacion është 6.559 km.
- 4) Fushë Kosovë - Pejë e ndërtuar në vitin 1936 me gjatësi 81.261 km dhe gjatësi në stacion 21.511 km.
- 5) Klinë - Prizren e ndërtuar në vitin 1963 me gjatësi 58.435 km dhe gjatësi në stacion 11.420 km.

Si pasojë e mungesës së investimeve në hekurudha gjendja e tyre është mjaft e keqe. Shpejtësia maksimale e lejuar vetëm në pak vende është 80 km në orë. Mirëmbajtja e hekurudhave është në nivel të ultë, ato po dëmtohen nga mbikalimet e paautorizuara, nga ndërtimet ilegale në brezin hekurudhor dhe hudhja e mbeturinave në afërsi të tyre.

Aeroportet

Në Kosovë sot ekziston aeroporti civil në Slatinë afër Prishtinës dhe aeroporti për nevojat e KFOR - it afër Gjakovës.

Dimensionet e pistës së aeroportit në Slatinë janë 2500 m X 45 m. Ndërtesa në terminalin e udhëtarëve ka dyshemenë me sipërfaqe 3500 m² që mjafton

për 354000 udhëtarë, ndërkaq platforma e aeroplanëve ka sipërfaqe rreth 24700 m² që mund t'i pranojë 5 aeroplanë të kategorisë së mesme Ekzistojnë edhe 12 fusha ajrore - aerodrome bujqësore të Aviokosovës dhe një fushë ajrore e Federatës Aeronautike të Kosovës në Dumosh. Shumë prej aerodromeve bujqësor janë në gjendje të keqe fizike dhe pa përkujdesje.

Transporti automobilistik

Sot (viti 2004) në Kosovë janë rreth 250000 automjete. Shërbimi i transportit publik të udhëtarëve realizohet nga 15 kompani shoqërore dhe 278 operatorë transportues privat të licencuar nga MTPT. Të gjitha këto kanë në dispozicion 864 autobusë dhe 22 stacione të autobusëve.

Transporti hekurudhor

Transporti hekurudhor në Kosovë është në nivel shumë të ultë. Kjo është si pasojë e infrastrukturës së pazhvilluar hekurudhore. Sot (viti 2004) nëpër hekurudhat e Kosovës lëvizë vetëm një tren për transportin e banorëve minoritarë dhe udhëtarëve tjerë të rastit dhe kjo vetëm në dy relacione : Fushë Kosovë - Miradijë - Graçanicë dhe Mitrovicë - Fushë Kosovë - Hani i Elezit dhe anasjelltas. Po ashtu me tren transportohet edhe një pjesë e mallrave për nevojat e UNMIK - ut dhe KFOR - it.

Transporti ajror

Nga aeroporti i Prishtinës udhëtarët udhëtojnë në destinacione të ndryshme në Europë. Kjo mundësohet nga aviokompani të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore. Në vitin 2003 nga aeroporti dhe për në aeroport janë realizuar 4157 fluturime me gjithsej 835302 udhëtarë.

VLERËSIMI DHE ORIENTIMET, UDHËZIMET POLITIKE

Nëse jepet një vlerësim i përgjithshëm për gjendjen ekzistuese të transportit dhe infrastrukturës që lidhet me të, në rend të parë duhet të potencohet niveli i ultë i zhvillimit të hekurudhave dhe transporti gati inekzistent hekurudhor që si pasojë përveç tjerash ka tejnqarkimin e rrugëve automobilistike dhe rrjedhimisht dëmtimin e tyre. Duhet të përmendet gjithashtu dukuria shumë shqetësuese e dhunimit të brezit rrugor dhe hekurudhor nga ndërtimet e egra. Vazhdimi i kësaj dukurie do të mund të çonte deri të pamundësia që rrugët magjistrale të zgjerohen në të ardhmen. Gjendja fizike e rrugëve brenda qyteteve të Kosovës është në nivel jo të dëshirueshëm, ndërkaq pas intervenimeve që janë bërë pas luftës, gjendja fizike e rrugëve magjistrale dhe regjionale është përmirësuar dukshëm. Infrastruktura rrugore në zonat rurale është në nivel mjaft të ultë të zhvillimit. Momentalisht Kosova ka mbetur jashtë planeve për lidhjen e vendeve të Ballkanit me Evropën përmes korridoreve rrugore E8 dhe E10 meqë asnjëri nga këta korridore rrugore nuk do të kalojë nëpër Kosovë. Është nevojë jetike që Kosova të ketë qasje sa më të lehtë në këta korridore por gjithashtu edhe në magjistralen e Adriatikut. Një prej synimeve më të rëndësishëm të Kosovës sa i përket transportit është lidhja me korridoret panevropiane. Në korridorin E10 Kosova do të mund të kyçej përmes magjistrales M25 (Prishtinë - Podujevë) apo autostradës Merdar - Durrës që është në fazën e projektimit - it. Në korridorin E8 (Durrës - Varna) Kosova do të mund të kyçej përmes magjistrales M2 (Ribariq - Hani i Elezit), ndërkaq me magjistralen e Adriatikut do të mund të lidhej përmes magjistrales M9

(Prishtinë - Pejë - Kullë). Po ashtu synim për të ardhmen është arritja e standardeve të BE në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Sipas Ministrisë së Transportit dhe Postë - Telekomunikacionit (MTPT) është shumë e rëndësishme të hartohen programe afatgjatë dhe afatmesëm për zhvillimin e infrastrukturës rrugore. MTPT synon të ketë një bashkëpunim të mirë me vendet fqinj për zhvillimin e transportit. Një synim tjetër shumë i rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës është ngjallja dhe zhvillimi i transportit hekurudhor dhe infrastrukturës që lidhet me të. Së pari të gjitha qytetet më të mëdha do të lidheshin përmes hekurudhave, pastaj Kosova do të lidhej me të gjitha vendet fqinj dhe hekurudhat do të elektrifikoheshin. Kjo do të shkarkonte mjaft rrugët automobilistike nga tejnqarkesa dhe ato më gjatë do të mbeteshin të padëmtuara. Zhvillimi i aeroportit të Prishtinës në aeroport kryesor rajonal me lidhje ajrore ndërkontinentale dhe zhvillimi i aeroportit të Gjakovës në një aeroport për operime civile janë synime të MTPT.

PRIORITETET STRATEGJIKE DHE ZONAT E VEPRIMIT

Rrugët - projektet kapitale :

- 1) Autostrada Morinë – Merdare 111.5 km tani më është në fazën e projektimit
- 2) Unaza (qarkorja) e Prishtinës 40 km

Prioritetet për zgjerimin e rrugëve:

- 1) Magjistralja M 2 Hani i Elezit - Mitrovicë 100.3 km
- 2) Magjistralja M 22.3 Mitrovicë - Leposaviq - kufi 53.6 km
- 3) Magjistralja M 9 Prishtinë - Pejë 80.6 km
- 4) Magjistralja M 25.2 + M 25.3 Prishtinë - Gjilan - Konçul 62.7 km
- 5) Rruga regjionale R 107 Prizren - Gjakovë - Pejë 66.9 km

Ndërtime të rrugëve të reja:

- 1) Rruga regjionale Komoran - Carralevë (pjesa Shalë - Carralevë)
- 2) Rruga Shurdhan - Stanishiq pjesa e dytë

Prioritete tjera :

- 1) Riparimi dhe ndërtimi i urave në magjistralen M2, pjesa Prishtinë - Hani i Elezit
- 2) Hartimi i studimit gjithëpërfshirës për rrjetin e rrugëve magjistrale dhe rajonale të Kosovës - Analiza e gjendjes dhe kërkesat për investime
- 3) Hartimi i studimit të fizibilitetit (arsyeshmërisë ekonomike) për projektet e zgjerimit dhe të korridoreve panevropiane
- 4) Sigurimi i burimeve të sigurta për fondet rrugore duke ndarë një përqindje nga shitja e derivateve të naftës dhe nga taksat rrugore
- 5) Ndërtimi i rrugëve tranzite për qendrat komunale

Vendkalimet kufitare - Investime në përmirësimin e gjendjes

Transporti:

- 1) Formimi i një qendre kryesore të informatave - database - për transportin e brendshëm dhe të jashtëm me seli në Prishtinë
- 2) Harmonizimi i linjave ndërurbane
- 3) Modernizimi dhe mosprivatizimi i stacioneve të autobusëve
- 4) Dhënja me koncesion e transportit ndërurban
- 5) Formimi i një grupi ekspertësh nga lëmi i transportit që do të bënte analizat e frekuentimit të udhëtarëve nga qendrat tjera në Prishtinë dhe anasjelltas

6) Eliminimi i kombibusëve nga transporti ndërrurban

Hekurudhat:

- 1) Pastrimi i brezit mbrojtës të hekurudhës nga ndërtimet dhe hedhurinat
- 2) Elektrifikimi i vijave hekurudhore
- 3) Pajisja e vijave hekurudhore me pajisje bashkëkohore të shenjzimit - sigurimit dhe të ndërlidhjes
- 4) Ripërtëritja e mjeteve tërheqëse dhe të tërhequra (lokomotivat, garnitura motorike, vagonët)
- 5) Ndërtimi i vijave të reja hekurudhore, urbane - ndërrurbane (Kramovik - Gjakovë dhe Ferizaj - Gjilan) dhe Prizren - Shqipëri
- 6) Aktivizimi i vijave hekurudhore pasive në relacionin Besianë - Fushë Kosovë - Pejë dhe Prizren
- 7) Projekti ideor për ripërtëritjen - ndërtimin e vijës hekurudhore Prishtinë - Fushë Kosovë - Bardh - aeroporti i Slatinës
- 8) Ripërtëritja e objekteve në shërbim të komunikacionit
- 9) Anëtarësimi në UIC

Aeroportet:

- 1) Licensimi i aeroportit të Prishtinës
- 2) Përpilimi i master planit të ri të aeroportit nga Swedavia
- 3) Ngritja e kodit referent të aeroportit të Prishtinës në 4E
- 4) Ngritja e pajisjeve të navigacionit dhe atyre vizuale për aterrim të aeroportit të Prishtinës në kategorinë e dytë
- 5) Investimet në aeroportin e Gjakovës që ky të mund të kryejë edhe funksionin e aeroportit civil
- 6) Tërheqja e kompanive ajrore që operojnë me çmime të ulëta (low cost carriers)
- 7) Mbrojtja e fushës ajrore sportive dhe e 12 fushave ajrore bujqësore
- 8) Përforsimi dhe rishtruarja e pistës.
- 9) Zgjatja dhe zgjerimi i platformës.
- 10) Ndërtimi i platformës për "De-icing".
- 11) Zgjerimi i shtegut kryesor të qarkullimit.
- 12) Ndërtimi i garazhës për automjetet zjarrfikëse dhe të shpëtimit.
- 13) Gardhi i ri rrethues dhe rruga e re rrethuese.
- 14) Përmirësimi i sistemit drenazhues.
- 15) Përpilimi i studimit për terminalin e udhëtarëve.
- 16) Projektimi i sistemit për furnizim me ujë dhe sistemit për ujrë e zeza.
- 17) Analizimi i ndërtimit të përgjatë të kontrollit të trafikut ajror.

Lista e projekteve në zbatim

Rrugët :

- Puna në projektin e autostradës Morinë - Merdare
- Rikonstruktimi dhe asfaltimi i disa rrugëve (shumica rrugë lokale) ekzistuese
- Mirëmbajtja verore e rrugëve magjistrale dhe regjionale
- Rikonstruktimi i urave në relacionin Prishtinë - Hani i Elezit
- Punimi i nën strukturës së urës Erenik - Gjakovë
- Asfaltimi i segmentit rrugor Ponošec - Qafë e Morinës (magjistralja M9.1)
- Projekti për ndërtimin e urës Ponošec - Qafë e Morinës
- Asfaltimi i segmentit rrugor Pejë - Kuqishtë (magjistralja M9)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Gjakovë - Qafë Prushi (regjionale R203)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Shirokë - Sopi (regjionale R118)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Istog - Vrellë (regjionale R103)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Gjonaj - Bistrashin I+II (regjionale R112)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Gjonaj - Bistrashin III (regjionale R112)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Komoran (Bushat) - Carralevë (regjionale R102)

- Asfaltimi i segmentit rrugor Zhegër - Shurdhan (regjionale R212)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Bellobrad - Bresan (Zaplluzhë) (regjionale R222)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Rahovec - Brestovc - Krushë e Madhe (R204)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Turiqec - Rezallë (regjionale R105)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Dule - Malishevë (regjionale R119)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Suharekë - Reçan (regjionale R205)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Kramovik - Xërxë (regjionale R111)
- Asfaltimi i segmentit rrugor Carabreg - Voksh - Junik (regjionale R109)

Transporti :

- Debati me AKM rreth privatizimit të stacioneve të autobusëve
- Licencimi i operatorëve transportues
- Vërtetimi i orareve në linjat ndërrurbane

Hekurudhat :

- Riparimi gjeneral i mjeteve tërheqës
- Aftësimi dhe vënja në funksion e sistemit të shenjzimit - sigurimit automatik elektroreleik në vijën hekurudhore Hani i Elezit - Leshak
- Shtrirja e kabllit optik për mjetet e ndërlidhjes në relacionin Fushë Kosovë - Hani i Elezit
- Terminali për ngarkimin - shkarkimin e mallrave në hekurudhë

Aeroportet:

- Përpilimi i Master Planit të ri nga Swedavia.
- Rruga e re hyrëse e Aeroportit të Prishtinës - e përfunduar.
- Gardhi i ri rrethues dhe rruga e re rrethuese.
- Implementimi i dy radarëve të rinj.

Dokumentacioni ekzistues, lista e materialeve

Materiali për sajimin e raportit të mësipërm është marrë i shtypur në letrat e formatit A4 nga zyrtarët përgjegjës të MTPT gjegjësisht departamenteve si më poshtë :

- Departamenti i infrastrukturës rrugore - Drejtoria e rrugëve të Kosovës
- Departamenti i transportit të aviacionit civil, hekurudhor dhe detar -
Divizioni i transportit hekurudhor
- Departamenti i transportit të aviacionit civil, hekurudhor dhe detar -
Divizioni i transportit ajror
- Departamenti i shërbimeve të transportit rrugor